

BASHKIM KUÇUKU

DYZET VJET PA KONTAKT ME LEXUES

Duke hulumtuar letrat e shkrimtarit, dërguar miqve, dallohet pa vështirësi se shkrimtarin nuk e shtyjnë të shkruaj letra dhe lapsi. Edhe mendimet dhe emocionet e tij, që godasin së brendshmi e mezi presin sa të çlirohen për t'u mishëruar në tekst, nuk janë tërësisht përcaktuese. Më e rëndësishme është qenia e lexuesit, zhytur në thellësi të vetëdijes dhe të pavetëdijes së tij, dhe, që i vegon në mendje, afër ose larg dhe e detyron atë të rrijë ulur në tryezë gjatë gjithë jetës e të shkruajë për të, duke shterur energjitë intelektuale më të mëdha, talentin, dijet e shumta, madje, duke përdorur shpesh për të edhe kohën e çlodhjes dhe të kënaqësive njerëzore. Qëllimi fillestar dhe përfundimtar nuk është letërsia e mbyllur në vetvete, në kapakët e librave dhe në raftet e bibliotekave, por **lexuesi, ndikimi, zotërimi dhe bërja për vete e “perandorisë së tij”**. Edhe censura, duke mos pasur mundësi të tjera ndëshkimi, pikërisht, atë u ndaloi shkrimtarëve disidentë të diasporës, mu në mesin e botës së lirë. Shkëputja prej tij, në ato rrethana, ishte dënimi më i rëndë. Me këtë u përpoq t'u humbte qëllimin e qenies krijuese dhe të veprës së tyre, pra, dhe të krejt qenies e të jetës njerëzore. Edhe Martin Camaj, që pati talentin e madh, lirinë, kulturën e gjerë, formimin letrar evropian modern bashkëkohor dhe përkushtimin e përhershëm ndaj letërsisë, në gjallje, nuk pati lexues, veç disa miqve të tij.

Në këtë kontekst të funksionit të shkrimtarit është proverbiale thënia e tij: *“Prej letërsisë kam pasë gjithçka, edhe vullnetin me jetue”* (Letër Idriz Lamajt, 22.8.1989). Ai ka jetuar me vullnet dhe durim për të shkruar letërsi. Edhe kur jeta ka qenë tepër e vështirë, vullnetin për ta përballuar e ka gjetur në përkushtimin ndaj letërsisë. E barazuar letërsia me lexuesin, kjo shprehje ka edhe domethënie tjetër, se edhe vullnetin për të jetuar e gjente te lexuesi, edhe pse asnjëherë nuk e pati. Nisur nga koha e tij, vullnetin për të jetuar e gjente te lexuesi i të nesërmes, pra, te lexuesi i të sotmes, i brezave të rinj. *“40 vjet pa kontakt me lexues”*, pohon i pikëlluar, dy vjet para vdekjes (Letër Gjon Sinishtës, 3.12.1990). Kjo ishte mungesa, vuajtja dhe ngulitja psikike më e madhe, sikurse ndërlidhja me lexuesin do të ishte plotësimi i dëshirës së jetës. *“Nëse do të botohen në Shqipëri (mbas*

ramjes së komunizmit !) do të jetë plotësim i të gjitha dëshirave» (po aty, *Letër Gjon Sinishtës*, 3.12.1990).

Ka qenë e mirëditur se letërsia disidente e emigracionit ndalohej rreptësisht të hynte në Shqipërinë shtetërore, por nuk ka qenë e ditur se pengohej me mënyra dhe me mjete nga më të ndryshmet, deri dhe me kërcënime ndaj autorit dhe lexuesve, edhe në Kosovë dhe atje larg, kudo që ishin. Në letrat e Martin Camajt, dërguar miqve, me fakte, ndër të tjera, zbulohet edhe kjo anë e panjohur prej këndeje e rolit pengues e ndalues të censurës, shtrirja e dorës së kësaj edhe tej kufijve shtetërorë. Me të dhëna të tilla ka për t'u hapur një kapitull më vete i *Historisë së letërsisë shqipe bashkëkohore*, që pritet të shkruhet.

Deri nga fundi i viteve '70 Martin Camaj, të paktën, sipas epistolarit vetjak, nuk ka qenë objekt vëzhgimi i veçantë i informatorëve të censurës në emigracion, pasi në veprat e tij, kryesisht, poetike nuk ishin shpalosur drejtpërdrejt probleme politike. Më 1978, me nismën dhe me paret e tij dhe të familjes, boton kompletin e parë nga *Varg librash letrarë "Biblioteka shqipe"*, përkatësisht: *Rrathë*, roman, vëllimi i parë, dhe *Njeriu më vete e me tjerë*, poezi, vëllimi i dytë. Me daljen e tyre, menjëherë nis edhe fushata e saj kundërcamaj, e cila brenda disa muajve arriti të ndalojë përhapjen e librave, veçanërisht në Kosovë, ku kishin mbërritur 20 kopjet e para, dhe ishin shenjat e mbara të një tërheqjeje më të madhe. Që në fillim dhe gjatë vitit '79, shkrimtari ka shkruar radhazi disa letra plot shqetësim për trysninë dhe kërcënimet për t'i bllokuar. Në letrën drejtuar Idriz Lamajt, më 3.1.1979, përshkruhen krahas dy pamje krejt të ndryshme. Në njërin është pranimi dhe tërheqja e lirë, e njëmendët e lexuesve, institucioneve përhapëse, ndërsa në tjetrën kundërpropaganda, mekanizmat e fshehtë dhe pengesat e tyre për t'i ndaluar. Camaj këtë proces e emërton me terma të teorisë bashkëkohore të receptimit, konkretisht, *momenti i receptimit* dhe *reagimi në Shqipëri dhe në Kosovë*, ndarë, po e quajmë, në tri kohë ose në tre akte.

Koha ose akti i parë: "a) Afro 20 complete, shkruan ai, kanë mbërritë qysh në shtator në Prishtinë. Sidomos shkrimtarët dhe kritikët, simbas të dhanave të sigurta e pa teprim, një herë kanë mbetë si të shtanguem...". Për këtë shtangje kishte disa shkaqe. Camaj, sikurse dihet, veprat e para: *Nji fyell ndër male* (1953) dhe *Kanga e vërrinit* (1954) i botoi në Kosovë, dhe, kështu, edhe komunikimin e parë e pati me lexuesit e atij mjedisi. Mirëpo, që atëherë kishin kaluar 25 vjet. Veprat e kësaj ndërkohe, dalë në Romë dhe në Muni, nuk dihet nëse kishin mbërritur dhe sa ishin njohur prej tyre, mbase pak, ose aspak. Takimi i tij rishtas nuk ishte vetëm me lexues e shkrimtarë të brezit të vet, por këtë herë, më shumë me lexues më

të arsimuar dhe me shkrimtarë të brezit të ri, me formim letrar modern dhe bashkëkohor. E, mbi të gjitha, vet Martin Camaj ishte një shkrimtar tjetër, me kulturë të gjerë, integruar në mjedisin letrar perëndimor, me koncepte, pëlqime e shije skajshmërisht moderne bashkëkohore, e, në këtë mënyrë, edhe poezia e sapodalë *Njeriu më vete e me tjerë*, ishte thujse, risore, e panjohur në poezinë shqipe, sikurse dhe romani *Rrathë*.

Pas shtangies nga befasia, që, ndofta, nuk ishin paramenduar ndryshime kaq cilësore dhe prurje të tilla, vjen **koha ose akti i dytë** i entuziazmit, e, bashkë me të edhe dëshirat dhe kërkesat për t'i ribotuar në Prishtinë, kuptohet, që të kishte mundësi më të shumta për t'ia afruar lexuesit.

“b) *Në të dytën kohë, shkruan autori në të njëjtën letër, u shfaq një entuziazëm edhe tek ata ku s' pritej, si p.sh. te Qosja që si e dini është mjaft doktrinar kur gjykon mbi tjerët si kritik. Disa profesorë të Universitetit të Prishtinës që qenë këtu në tetor më propozuen apo pyetën: nëse Rilindja don ta rishtypë romanin (Rrathë) e kishit me e lejue? Natyrisht, thashë, pa ndërrue asnjë fjalë, se po.*”

Në atmosferën e mirëpritjes së ngutshme të shkrimtarëve, institucionet e Prishtinës do të kenë ndikuar edhe në qarqet zyrtare jugosllave, të cilët, pa e ditur përmbajtjen e tyre, merrnin të dhëna për t'u hapur derën e qarkullimit.

“c) *Nga libreria për libra të huej në Belgrad, vazhdon letra, erdhën disa pyetje tek libraritë e Münchenit Sagner dhe Trofenik sa kushton kompleti. Mbrenda një mueji ndërroi gjithçka.*” Në dy kohët e para është receptimi i njëmendët, sepse është i lirë dhe i natyrshëm.

Koha ose akti i tretë është dramatik, përmbysje e gjendjes së mëparshme. “*Ndërkaq ndërhyrja e Tiranës që ka marrdhanie kulturore me Kosovë: sikur të pranoheshin librat e mij në Kosovë, ata do të merrshin masa. Në Kosovë ma të parët me u tërëhjekë qenë vetë shkrimtarët, ndoshta sepse ndokush mund t' i au ketë ngrehë veshin*”, i shpjegon me keqardhje mikut të vet. Ndërhyrja e Tiranës në ndalimin e veprave të shkrimtarëve disidentë ka qenë vendimtare. Kështu do të ketë ndodhur edhe me romanin *Ra Berati* dërguar *Rilindjes* nga Bilal Xhaferi prej SHBA-ve, më 1972, i cili mbeti dorëshkrim gjersa ra censura në Shqipërinë shtetërore.

Pas disa ditësh, në letrën drejtuar Z. Logoreci (17.2.1979) përshkruhet përsëri e njëjta situatë dhe gjendje e dëshpëruar e autorit. Këtë herë ka dijeni të saktë edhe për mënyrën e funksionimit të censurës. “*Kam pasë të çame kreje të mëdha për roman të cilin e keqinterpretuen në shumë rrethe, besoj, gabim: politikisht. Në Tiranë është një rreth letraro-funksionarësh që merret me censurë dhe interpretacion...edhe këto dy vepra po mbesin pa*

lexues sepse më blokuen në të katër anët: as në Kosovë nuk i lanë me kalie.” Këta funksionarë kanë përgatitur edhe një, siç e quan Camaj, *Memorandum-*, saktësisht shkrim asgjësues, *çue në Prishtinë...dhe ...botue (ende nuk e di se ku!)* (Letër Idriz Lamajt, 3.1.1979). Dhe riprodhon disa rreshta prej anatemës kundër tij, me gjuhën e zakonshme të saj, mbushur me epitete rënduese dhe kategorizime zhvlerësuese à priori e pejorative, pavarësisht nga vlerat letrare, mjafton që kishin përmbajtje politike kundër sistemit. Në copëzën e anatemës shkruhet: “*teoricienti më i rrezikshëm borgjez...*”, “*...me shfaqjet folklorizante e etnografike, përshkrimin e jetës zakonore e të dokeve të vjetra patriarkale, me zbulimin e skutave ekzotike që zgjojnë interesin e të huajve, thua se letërsia duhet të shndërrohet në një manual a guidë turistike.*” (Letër Idriz Lamajt, 3.1.1979).

Pas tre vjetësh shkrimtari e ndjen se mekanizmi ndalues është përforcuar dhe është shtrirë kudo ku ka shqiptarë, që mund të lexojnë. Nga reagimet kupton se edhe bota e atjeshme e diasporës, larg dhe e lirë, është nën trysni dhe kërcënim: “*Jam ngusht për punën e librave letrarë të mij, në çdo pikëpamje, i qahet mikut më intim e më të besueshëm, Atë Danielit me të cilin u largua fshehurazi nga Shqipëria. Mirëpo kjo botë këtu dhe atje në vend qenka fort e kapërthyme dhe e lidhun me tetëqind tëjza të papashëm!...Prej të katër anëve ka fillue një sabotim që mos të shpërndahen këta libra as në diasporë, as në Kosovë e në Shqipëri, jo që jo! Më kanë bllokue krejtisht.*” (Letër Atë Danjelit, 6.2.1982). Në Kosovë, ku u pritën me entuziazëm, qëkur filloi pengimi dhe deri më 1982-shin, kur është shkruar kjo letër, mbase deri më 1990, nuk ishte blerë asnjë copë.

Pengimi në diasporë, edhe pse jo aq i besueshëm për ne të këtejshmit sa për në Shqipëri e Kosovë, ka qenë njëmendësisht i tillë. Në letrë nuk paraqitet si dhe në ç’mënyrë, sepse s’kishte si ta merrte vesh, por pasojat e përshkruara, të para me sy e të përjetuara prej tij së thelli, janë tronditëse. “*Edhe njerëzit që njoh prej asaj ane (Kosovës) rrudhin shpatullat e më thonë “Martin, çdo (gja?) báj për ty, por librat tu s’guxoj as me i hapë! Rueji këtu! Zoti do e shlirohet puna”* (Letër Atë Danjelit, 6.2.1982). Edhe në Amerikën e largët, gjithashtu, tërhiqen mbrapsht dhe tregohen krejt indiferentë. “*Në Amerikë nuk kanë reague aspak as njerëzit tanë: vërtetë se e kam lidhjen me shumicën, por ata që po më shkruajnë (tue përjashtue nja disa) qesin arsye të ndryshme për mos me i prekë me dorë.*” (Letër Atë Danjelit, 6.2.1982).

Camaj nuk ishte prej atyre që i kishin kthyer shpinën dhe e shpërfillnin letërsinë që shkruhej në atdhe, meqenëse i ishte nënshtruar metodës së realizmit socialist. Sipas bibliotekës vetjake në Lengris, ku gjenden edhe

vepra të gjedhes së saj, si dhe epistolarit, duket se e ndiqte me vëmendje, njihte kërkesat, kontrollin detyrues të censurës dhe ndëshkimet e parashikuara. Sa ishte në Romë e përcillte herë-herë edhe me shkrime të *Shêjzat*, lexonte ato që gjente, dinte çfarë kërkohej dhe çfarë nuk lejohej, prandaj e kishte të qartë edhe atë që ndodhi me veprën e tij. “*Ndalimi i veprave të mia letrare dhe jo letrare*, shpjegon në shënimet e mbajtura për një intervistë, dhënë *Zërit të Amerikës* (1990/1991), *në vendin tim nuk më ka befasue kurrë...Për mue ashtë e logjishme që nga fillimi u ndaluen ... në Shqipni e ma vonë edhe në Kosovë*”. Shkaku argumentues i tij është qëndrimi moral dhe filozofik, miratimi apo kundërshtimi ndaj dukurive të trajtuara, edhe pse ai lind natyrshëm te shkrimtari, pa paramendim ideologjik. Dhe merr për shembull veten se si *instiktivisht kam marrë anën e individit, njeriut kall të vetëm*, me të cilën kuptojmë humanizmin pannjerëzor, mëshirën ndaj të pambrojturit e të braktisurit ose të vetmuarit, që ngjan e përputhet edhe me gjendjen e tij. Kështu, veprat e tij janë në kundërshtim me realizmin socialist, që “*hymnizon kolektivin dhe nga individi, përbamës i kolektivit, lyp nënshtrim, disiplinë, vetmohim etj.*”

Shkak tjetër janë përbërësit, ndofta, mënyrat dhe teknikat letrare të papëlqyeshme në Shqipëri, ndër to, edhe liria e përdorimit të formave, ato që zyrtarisht cilësoheshin dekadente borgjeze, ndikime të huaja dhe reaksionare. Me këtë rast, ve në dukje jo pa ironi edhe ngushtësinë dhe vulgaritetin e kërkesave të asaj metode. “*Në letërsinë time ka edhe elementa rrymash letrare që nuk pëlqehen në Shqipni, ndër to edhe liria e përdorimit të formave. Në formë nënkuptoj edhe gjuhën sepse edhe fjalët që duhet të përdorë shkrimtari janë të caktueme në Tiranë: ka fjalë e forma “socialiste” apo “kombëtare” e asosh “reaksionare”, të ndalueme*” (Shënime për një intervistë dhanë *Zërit të Amerikës*, 1990/1991)

Si përfundim, marrëdhëniet shkrimtar-lexues të Camajt, mes të cilave ndërhyri censura për t’i shpërbërë krejtësisht, mund të përmbliken nëpërmjet këtyre thënieve proverbiale/postulateve të tij:

1. **Prej letërsisë** (me këtë të kuptohen lexuesit) **kam pasë gjithçka, edhe vullnetin për të jetue.**

2. **Dyzet vjet pa kontakt me lexues.**

3. **Nëse do të botohen në Shqipni (mbas ramjes së komunizmit !), pra, nëse do t’i jepen lexuesit, do të jetë plotësim i të gjitha dëshirave.**

4. **Ndonëse të ndamë për gjysmë shekulli, unë** (le të konkretizohet-shkrimtari) **jam i jueji e ju** (le të kuptohen- lexuesit) **jeni të miji.**

